

HASAN BELLO**KOMUNITETI MYSLIMAN SHQIPTAR NË VITET
E LUFTËS SË DYTË BOTËRORE
(1939-1944)**

Pushtimi italian krijoi rrethana të reja për Komunitetin Mysliman Shqiptar (KMSH) dhe myslimanët shqiptarë. Për interesat e luftës dhe për të mbrojtur zotërimet koloniale franceze në Afrikën Veriore, Franca vuri në përdorim kartën e myslimanizmit. Shtypi dhe radiot parisiane filluan një fushatë intensive antiitaliane drejtuar vendeve myslimane. Propaganda e tyre e paraqiste pushtimin e Shqipërisë si një përpjekje për të zhdukur të vetmin vend mysliman në Europë dhe fashizmin si një kërcënim për botën islame.¹ Propaganda italiane u përpoq ta kundërgodiste këtë fushatë. Gazeta *Giornale d'Italia* denoncoi propagandën e radio Paris-Mondial, e cila analizonte ndërhyrjen italiane në Lindje dhe deklaronte se ajo binte ndesh me interesat e myslimanëve në Shqipëri. Ajo propagandonte se Italia, ashtu si kishte vepruar në Etiopi dhe Libi, do të vepronte edhe në Shqipëri, duke ndërtuar xhami të reja dhe duke ndjekur një politikë në favor të interesave të popullsisë myslimane. Kjo gazetë sulmonte edhe politikën fetare të Mbretit Zog, duke e cilësuar atë antiislame, dhe e akuzonte Mbretin shqiptar se, pasi ishte martuar me një kristiane, kishte grabitur pasuritë e KMSH-së dhe ia kishte shpërndarë urdhrave dhe kishave katolike.² Kjo kundërpropagandë ishte në funksion të politikës mikluese që regjimi fashist ishte i detyruar të bënte për shkak të medias perëndimore që i nxiste myslimanët shqiptarë kundër fashizmit.

¹ *I Documenti i Diplomatici Italiani*, Ottava serie, 1935-1939, V. XI (1 Gennaio – 22 Maggio 1939), (ed.) Pietro Pastorelli, Ennio Di Nolfo, Roma: Istituto Poligrafico dello Stato 2007, dok. nr. 515. Telegram i ministrit të Punëve të Jashtme, kontit Çiano, për ambasadën italiane në Ankara dhe legatave në Athinë, Bagdat, Xheda, Kajro, Kabu, Romë, 9 prill 1939.

² “Italia do të vendosë në Shqipëri së shpejti një politikë në favor të myslimanëve”, *Shtypi*, nr. 570, Tiranë, 12 prill 1939, f. 2.

Drejtuesit e KMSH-së u gjendën përballë një situatë tepër të vështirë. Në disa qarqe të caktuara flitej hapur se kishte ardhur koha që myslimanët të largoheshin drejt Azisë. Kjo bëri që kryetari i KMSH-së dhe ndonjë klerik të konformoheshin me pushtuesit. Kështu, në ceremoninë e inaugurimit të Xhamisë së Re në Durrës, ku merrte pjesë Mëkëmbësi i Përgjithshëm, drejtuesit e Partisë Fashiste dhe përfaqësuesit më të lartë të shtetit, kryetari i KMSH-së theksoi besnikërinë e të gjithë myslimanëve shqiptarë ndaj regjimit fashist. Ndërsa Mëkëmbësi e siguroi kreun e KMSH-së për mbrojtjen e myslimanëve dhe se mesazhet e ngrohta të tyre do t'ia përcillte personalisht Benito Mussolinit.³

Konformizmi i kryetarit, Dr. Bexhet Shapati ngjalli pakënaqësinë e një pjese të myslimanëve. Në një peticion drejtuar kryeministrit, i firmosur nga 40 besimtarë, kërkohet reformimi i KMSH-së dhe formimi i një asambleje, e cila do të shqyrtonte veprimtarinë e deritanishme të këtij institucioni nga çdo pikëpamje, të përcaktonte masat e nevojshme dhe të formonte Këshillin e Përgjithshëm.⁴

Për të mikluar klerikët, pushtuesit fashistë përdorën disa taktika. Së pari, ata revizionuan reformat laike dhe moderne që ishin zbatuar gjatë periudhës së republikës dhe monarkisë në sferën e arsimit, ku lënda e mësim-besimit ishte reduktuar në maksimum. Ministria e Arsimit, shkruante se besimi ishte baza e moralit familjar dhe shoqëror, prandaj ajo planifikonte ta rivendoste në programin e shkollave fillore si lëndë të detyrueshme. Por, sipas saj, për këtë nevojiteshin tekste me gjuhë të pastër dhe përmbajtje të thjeshtë. Ajo kërkoi nga Ministria e Drejtësisë të njoftonte komunitetet për të paraqitur sa më shpejt tekste të reja për këtë lëndë.⁵ Ministria e Drejtësisë kërkoi nga KMSH-ja që të ngrinte një komision prej tre vetash, ku të bënte pjesë edhe Hafiz Ali Korça, i cili ishte shkrimtar dhe njohës i mirë i gjuhës shqipe. Këshilli mori në shqyrtim kërkesën e mësipërme dhe caktoi si anëtarë të këtij komisioni H. Ali Korçën, Haki Sharofin dhe Jonuz Buliqin.⁶

³ “Inagurimi madhështor i Xhamisë monumentale të Durrësit në prani të Mëkëmbësit të Përgjithshëm”, *Fashizmi*, nr. 18, Tiranë, 13 qershor 1939, f. 2.

⁴ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 155, Viti (më tej: V.) 1939, dosja (më tej: D.) VIII-445, fl. 1. Letër e një grupi besimtarësh myslimanë, për Kryeministrinë, Tiranë, 8 dhjetor 1939.

⁵ *Po aty*, F.155, V.1939, D.VIII-438, fl.45. Letër e Ministrisë së Arsimit, për Ministrinë e Punëve të Brendshme, Tiranë, 11 korrik 1939.

⁶ *Po aty*, fl. 46.

Në gjithë Shqipërinë qarkullonin fjalë se pushtimi i vendit nga Italia, popullsia e së cilës ishte katolike, i ndërmarrë të “premtën e shenjtë”, ishte një kryqëzatë që synonte konvertimin e myslimanëve. Kjo bëri që më 10 prill 1939 avionët luftarakë italianë të fluturonin në lartësi të ulët mbi fshatrat dhe qytetet shqiptare, duke hedhur fletushka, ku u garantohej të gjithëve ushtrimi i lirë i besimit fetar. Kleri mysliman në përgjithësi e shprehu pakënaqësinë ndaj pushtuesit nëpërmjet qëndrimit shpërfillës. Kështu, autoritetet e qeverisë kuislinge konstatonin se në festat fetare nuk ishte përmendur asnjëherë emri i Viktor Emanuelit dhe i kërkonin KMSH të urdhëronte të gjitha myftinitë, që në ceremonitë të përmendej emri i tij.⁷ Pakënaqësia e autoriteteve italiane u shoqërua me masa konkrete.

Një nga aktet e para të regjimit fashist ishte spastrimi i KMSH-së dhe myftinive nga klerikët myslimanë, që konsideroheshin nacionalistë dhe ithtarë të Mbretit Zog. Kështu, Ministria e Brendshme konstatonte se kryemyftiu i Shkodrës, Sali Efendi, kishte qenë një nga eksponentët kryesorë të regjimit zogist dhe se, nën hijen e petkut fetar, kishte luajtur role të ndryshme “në dëm të popullsisë”. Ajo i sugjeroi Ministrisë së Drejtësisë që t’i kërkonte KMSH-së shkarkimin e Sali Efendiut, emërimin e një myftiu tjetër që të ishte “koshient” për misionin tepër delikat e që të kufizohej vetëm në çështje spirituale.⁸ Kjo kërkesë gjeti mbështetje edhe nga Jakomoni, i cili shprehu dëshirën për zëvendësimin e tij me Hafiz Sabri Bushatin, “që nuk merrej me politikë dhe ishte i përshtatshëm për situatën”.⁹ Një rast tjetër ishte ai i myftiut të Dibrës, Hafiz Raif Kadiu, i cili akuzohej se propagandonte me besnikët e kësaj krahine kundër politikës italiane dhe se veprimtaria e tij po merrte përditë e më shumë dimensione të rrezikshme.¹⁰

Autoritetet fashiste e detyruan KMSH-në që të urdhëronte imamët e xhamive që, mbas faljeve, të këndonin kaptinën e *Fet`hit* (pjesë nga Kur`ani) dhe *Salati tunxhinë* (lutje) për fitoren e ushtrisë italiane,

⁷ *Po aty*, F.155, V.1939, D.VIII-433, fl.2. Letër e ministrit të Drejtësisë për kryesinë e KMSH-së, Tiranë, 26 korrik 1939.

⁸ *Po aty*, F.155, V.1939, D.VIII-446, fl.3. Letër e Zyrës Sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 29 maj 1939.

⁹ *Po aty*, fl. 6. Letër e Ministrisë së Punëve të Brendshme për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 2 qershor 1939.

¹⁰ *Po aty*, fl. 17. Letër e Ministrisë së Punëve të Brendshme për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 9 qershor 1939.

mbarëvajtjen e luftës dhe Mbretërisë.¹¹ Kontrolli i këtyre autoriteteve u shtri jo vetëm mbi klerikët myslimanë që jetonin dhe vepronin brenda shtetit, por edhe mbi medresistët që studionin në vende të ndryshme të botës. Sekretaria e Përgjithshme e Mëkëmbësisë kërkoi nga bashkëpunëtorët e saj që kishte emëruar në organet drejtuese të KMSH-së, të kalonin në filtër të gjithë studentët që mbanin qëndrim antifashist. Kështu, sipas hetimeve të kryera, rezultoi se medresistët shqiptarë që studionin në Egjipt, Shaqir Uruçi, Hysni Hoxha, Mehmet Sabri Egro, Thabit Kaduku, Isa Hoxha, Nihat Gruda, Vehbi Hoxha kishin ushtruar aktivitet patriotik dhe ushqenin ndjenja kundër regjimit. Në mbështetje të kësaj politike organet drejtuese vendosën që këtyre studentëve t'u pritej bursa. Ndërsa për studentët Isa Hoxha nga Elbasani, Nihat Gruda nga Durrësi dhe Vehbi Hoxha nga Shkodra të mbaheshin shënime për t'iu refuzuar çdo lloj ndihme.¹²

Ndërhyrja e autoriteteve fashiste për imponimin e drejtuesve fetarë të nivelit lokal dhe qendror rritej nga dita në ditë. Kështu, nëpunës të posaçëm të karabinierisë, prefekturës dhe zyrës së Federalit u interesuan hollësisht në myftininë e Durrësit për zgjedhjet e anëtarëve të rinj të Këshillit të Përgjithshëm, duke u interesuar për orientimin e kandidatave në raport me politikën italiane.¹³

Për shkak të rrethanave politike, KMSH-ja informoi Ministrinë e Drejtësisë se anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm kishte vendosur t'ua zgjaste mandatin për një vit.¹⁴ Ky veprim ngjalli pakënaqësinë e Ministrisë së Brendshme, e cila synonte zëvendësimin e drejtuesve të vjetër me anëtarë të rinj, besnikë të regjimit.¹⁵ Megjithatë, Ministria e Drejtësisë vendosi të mos ndërhynte menjëherë, duke shkaktuar pakënaqësi tek drejtuesit e KMSH-së dhe besimtarët. Ajo paraqiti

¹¹ Ali Musa Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)*, Tiranë: 2011, f. 306.

¹² *AQSH*, F. 482, V.1940, D. 4, fl. 113. Vendim i Këshillit të Përhershëm të KMSH-së, Tiranë, 4 qershor 1940.

¹³ A. Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)*..., f. 306.

¹⁴ *AQSH*, F. 155, V. 1940, D. VIII-471, fl. 23. Letër e kryetarit të KMSH-së për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 2 prill 1940.

¹⁵ *Po aty*, F. 152, V. 1940, D. 196, fl. 3. Letër e ministrit të Punëve të Brendshme për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 8 prill 1940.

dekretin e Mëkëmbësit, i cili njoftonte se zgjedhjet për anëtarët e rinj të Këshillit të Përgjithshëm shtyheshin deri në 1 maj të vitit 1941.¹⁶

Autoritetet italiane u përpoqën që KMSH-në dhe klerikët myslimanë t'i përdornin në funksion të luftës. Kështu, Ministria Italiane e Kulturës kërkoi që, për të luftuar propagandën antiitaliane të radios angleze në botën myslimane, Inspektoriatit për Radion pranë kësaj ministrie duhej t'i dërgoheshin sa më shpejt disa mesazhe personalitetesh të larta myslimane nga Shqipëria, në të cilat duhej theksuar se Anglia ishte armike e myslimanëve dhe e besimit të tyre; se Italia ishte mike e fesë islame dhe luftonte për çlirimin e myslimanëve nga zgjedha anglo-çifute; se myslimanët e të gjithë botës duhej të vazhdonin luftën kundër kolonializmit britanik; se fitorja e Fuqive të Boshtit ishte e sigurtë etj. Tekstet e këtyre mesazheve duhej të ishin në gjuhën italiane. Ato do të përktheheshin në arabisht dhe do të jepeshin në transmetimet radiofonike për botën arabe.¹⁷ Në një fjalim që mbajti kryetari i KMSH-së në radio Tirana, glorifikoi pozitën e myslimanëve nën regjimin fashist, theksoi frymën armiqësore të anglezëve ndaj Islamit dhe myslimanëve në Lindje dhe, deklaroi se fitorja e Fuqive të Boshtit, ishte e sigurtë.¹⁸ Kryetari i KMSH-së doli hapur në mbështetje të Italisë, duke argumentuar pikëtakimet e fesë islame me doktrinën fashiste.¹⁹ Ky qëndrim kishte arsyet e veta dhe imponohej nga rrethanat e vështira të luftës. Por, për këtë ndikuan dhe disa faktorë të brendshëm.

Në këtë periudhë u shfaq një propagandë islamofobe e cila mund ta çonte vendin drejt luftës civile. Ajo e kishte burimin tek disa qarqe katolike, që e shihnin pushtimin italian si një moment të përshtatshëm për konvertimin e myslimanëve me dhunë. Ky qëndrim përputhej edhe me pikëpamjet e italianëve, të cilët, nuk kishin simpati për myslimanët. Kjo mishërohej dhe në propagandën e kohës duke akuzuar fenë islame se ishte kundër përparimit dhe se përkrahte sistemet shoqërore që

¹⁶ *Po aty*, F. 155, V. 1940, D. VIII-471, fl. 25. Letër e ministrit të Drejtësisë drejtuar Këshillit të Ministrave, Tiranë, 17 prill 1940.

¹⁷ *Po aty*, F. 154, V. 1940, D. 393, fl. 4. Letër e Ministrisë së Kulturës së Italisë për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë dhe Mëkëmbësinë e Përgjithshme në Tiranë, Romë, 9 tetor 1940.

¹⁸ "Radio-fjalimi i Eminencës Dr. Bexhet Shapati", *Tomori*, nr.231, Tiranë, 1 nëntor 1940, f. 2.

¹⁹ "Që myslimanët të jenë binj të denjë të Perandorisë fashiste", *Tomori*, nr. 279, Tiranë, 12 dhjetor 1940, f.1.

shkatërronin aspiratat e të varfërve; se ishte fe që përkrahte supersticionet dhe pengonte shkencën; se bazohej në mbështetjen e *kazasë* dhe *kaderit*; se lejonte poligaminë; se ishte përhapur me dhunë; se ishte zvetënuar pas periudhës së profetësisë²⁰; se Muhamedi i kishte përjashtuar gratë nga parajsa etj. Kësaj fushate iu shtua hedhja e kryqeve nëpër xhami në ditën e Kurban Bajramit, për të futur përçarjen midis myslimanëve dhe të krishterëve;²¹ vënia në qarkullim e kartolinave të ilustruara, të botuara në Itali, me frymë antishqiptare e antiislame; përhapja e misionarëve të krishterë të ardhur nga Vatikani, që shëtisnin nëpër rrugët e Shqipërisë për të mbledhur fëmijët jetimë dhe të varfër myslimanë me qëllim konvertimin e tyre në të krishterë etj. Këto ndikuan që drejtuesit e klerit mysliman, nga frika, të konformoheshin gjithnjë e më shumë me pushtuesit.

Presioni ekonomik i regjimit fashist ndaj KMSh-ës ishte i drejtpërdrejtë. Subvencionet e përcaktuara nga ligji i vitit 1929 për komunitetet fetare herë i jepeshin KMSh-ës dhe herë jo. Por edhe kur i jepeshin, nuk i jepeshin të plota. Kishte raste kur regjimi fashist disa klerikë i ndihmonte materialisht e disa të tjerë jo. Këtë e bënte për të shkakuar diversion ndërmjet hoxhallarëve.

Nëpërmjet një “këshilltari” italian të Ministrisë së Arsimit regjimi tentoi të ndërhynte në Medresenë e Përgjithshme, por duke qenë se atdheadashuria e nxënësve dhe e pedagogëve që e fortë, nuk mundi të penetronte sipas planit që kishte parashikuar.²²

Një propagandë e ngjashme zhvillohej edhe nga drejtuesit më të lartë të qeverisë kolaboracioniste. Kështu, kryeministri Mustafa Kruja, në konferencën me temë “*Karakteret natyrale e historike të Shqipërisë së Madhe*”²³ të mbajtur më 30 maj 1941 në selinë e Akademisë Mbretërore të Italisë në Romë, deklaronte se Shqipëria qëndronte, duke u mbrojtur prej rrezikut mysliman për 76 vjet rresht, pa marrë nga Evropa asnjë ndihmë për të përballuar invadimin.²⁴

²⁰ AQS, F. 482, V. 1960, D. 1, fl. 20-21. Raport mbi historikun e KMSh-së i përgatitur për nevojat e organeve qeveritare të regjimit komunist, Tiranë, 7 janar 1961.

²¹ Po aty, F. 149, V. 1941, D. VI-323, fl. 2. Letër e Kryeministrit Shefqet Vërlaci për Mëkëmbësinë e Përgjithshme, Tiranë, 10 nëntor 1941.

²² Po aty, F. 482, V. 1960, D. 1, fl. 20-21. Raport mbi historikun e KMSh-së i përgatitur për nevojat e organeve qeveritare të regjimit komunist, Tiranë, 7 janar 1961.

²³ Mustafa Kruja, *Caratteri naturali e storici della grande Albania*, Tirana: 1941.

²⁴ Po aty, f. 1-10.

Një qëndrim tendencioz dhe fyes ndaj Islamit dhe myslimanëve drejtuesit e revistës *Kultura Islame* konstatuan edhe në librin e delegatit apostolik, Leone Nigris, *Pasqyrë besimi*.²⁵ Këshilli i Ulemave, pasi shqyrtoi çështjen, vendosi që të ngarkonte redaksinë e revistës *Kultura Islame* që, ta studionte librin dhe t'u përgjigjej një për një të gjitha pasaktësive; të ngarkohej kryetari i Këshillit të Ulemave t'ia raportonte çështjen qeverisë, duke kërkuar ndalimin e botimeve që shkaktonin diversion fetar.²⁶

Gjendja e myslimanëve u vështirësua më tepër nga Lufta Italo-Greke, e cila u shoqërua me pasoja të rënda, jo vetëm për popullsinë, por edhe për objektet e kultit. Një numër i konsiderueshëm xhamish u shkatërruan, u përdorën si depo armësh apo vendstrehim për ushtarët dhe popullsinë e dhunuar.²⁷ KMSH kërkoi nga shteti dëmshpërblim pasi ky institucion nuk kishte mundësi financiare për restaurimin apo rindërtimin e xhamive.²⁸ Kjo kërkesë u përsërit disa herë, ²⁹por përgjigjja ishte e prerë: sipas ligjit, entet fetare nuk përfitonin asnjë kompensim për dëmet që kishte shkaktuar lufta.³⁰ Megjithatë kryetari i komisionit për dëmet e luftës (që ishte krijuar në Itali) njoftoi se, para së gjithash, do të interesohej për dëmet që kishin pësuar xhamitë. Sipas një përlllogaritjeje të Drejtorisë së Vakëfeve, shuma e tyre kapte një shifër prej 845.266 fr.³¹

Në kushtet e luftës, kur një pjesë e pronave dhe xhamive ishin dëmtuar dhe okupuar nga ushtritë italo-greke, të ardhurat e KMSH-së ishin pakësuar. Kjo krijoi një situatë të vështirë financiare. Për këtë arsye, KMSH kërkoi nga myftinitë që t'i bënin thirrje besimtarëve për ta mbështetur me kuotizacione, që varionin nga 1 deri në 5 franga shqiptare

²⁵ Leon Nigris, *Pasqyrë besimi: për klasë t'ulta të shkollave të mesme*, Shkodër: Shtypshkronja e Zojës s' Papërlyeme, 1942, f.84-85.

²⁶ *AQSH*, F. 482, V. 1942, D. 5, fl. 201. Vendim nr. 80 i Këshillit të Ulemave, Tiranë, 29 gusht 1942.

²⁷ *Po aty*, F. 155, V. 1941, D. VIII-485, fl. 37. Letër e kryetarit të KMSH-së, Dr. Bexhet Shapati, për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 29 shtator 1942.

²⁸ *Po aty*, F. 155, V. 1942, D. VIII-507, fl. 2. Letër e kryetarit të KMSH-së, Dr. Bexhet Shapati, për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 2 shkurt 1942.

²⁹ *Po aty*, fl. 3. Letër e kryetarit të Këshillit të Ulemave, H. Sherif Langu, për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 17 tetor 1942.

³⁰ *Po aty*, fl. 2. Letër e kryetarit të KMSH-së, Dr. Bexhet Shapati, për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 4 shkurt 1942.

³¹ A. Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)*..., f. 307.

për çdo shtëpi. Por, për shkak të rrethanave të vështira, kjo thirrje nuk solli ndonjë rezultat.³²

Mëkëmbësia dhe kryeministria bënë përpjekje për rishikimin dhe suprimimin e disa festave fetare, siç ishte “nata e mirë”, duke ngjallur indinjatë të thellë tek besimtarët dhe drejtuesit e KMSH-ës. Por nuk mungoi edhe ndonjë hap pozitiv. Kështu, myftiu i Pejës, Mulla Mustafai kërkoi nga KMSH që lutjet e të premtëve, për shkak se deri në çlirimin e Kosovës, klerikët myslimanë i kishin zhvilluar në gjuhën sllave, tani e tutje, t'i bënin në shqip.³³

Qeveria kuislinge u përpoq që bashkimit të trojeve shqiptare t'i jepte një solemnitë të madh. Me rastin e 28 Nëntorit, ajo urdhëroi KMSH që të hartonte një listë me disa klerikë, që do të dërgoheshin në Shqipërinë Juglindore për të zhvilluar lutje fetare. Lista e të përzgjedhurve përbëhej nga ish-medresistë, shpenzimet e të cilëve do të merreshin përsipër nga qeveria.

Për shkollimin e brezit të ri të klerikëve nga trojet etnike në Medresenë e Përgjithshme të Tiranës, KMSH kërkoi nga qeveria një shtesë buxheti që kapte shifrën e 70.000 fr. Ky institucion u përpoq me të gjitha format për përgatitjen e një numri të madh specialistësh dhe teologësh jo vetëm brenda vendit, por edhe në universitetet më të njohura të botës. Kjo strategji kishte si qëllim arsimimin e të rinjve shqiptarë nga të gjitha trojet, me njohuritë bashkëkohore të mendimit juridik dhe teologjik islam. Interpretimi i Islamit sipas teksteve burimore dhe me rigorozitet ishte imperativ për përsosjen, gërshetimin dhe forcimin e vlerave kombëtare e fetare. Por mundësitë e limituara financiare të KMSH-së, për shkak të dëmtimeve të luftës, ishin pengesë e pakapërcyeshme. Kjo bëri që shpeshherë këta studentë të gjendeshin në një pozitë të vështirë financiare. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe u diplomua një numër i konsiderueshëm teologësh, të cilët që gjatë periudhës së studimeve filluan të jepnin një kontribut të madh në shtypin islam, me përkthime dhe artikuj.

³² *Po aty*, f.308.

³³ *AQSH*, F.482, V.1941, D.19, fl.4. Letër e myftiut të Pejës, Mulla Mustafai, për kryesinë e KMSH-së, Pejë, 1941.

Kongresi Mysliman i Prizrenit (30 nëntor 1941). Unifikimi i bashkësisë islame

Në kohën e Jugosllavisë së paraluftës myslimanët shqiptarë bashkë me ata të Bosnje-Hercegovinës gëzonin një autonomi legale, duke i zgjidhur problemet juridike të karakterit civil (martesat, divorcet, çështjet e trashëgimisë etj.) nga gjykatat e Sheriatit. Arsimi fetar dhe administrimi i pronave vakëf ishte një e drejtë e njohur nga shteti jugosllav. Kjo autonomi u siguronte atyre një sasi të ardhurash nga vakëfet, ndërsa pjesa tjetër subvencionohej nga shteti. Qendra e bashkësisë islame, si për shqiptarët ashtu edhe për boshnjakët, ishte Sarajeva, ku ndodhej *Reis`ul Ulema* (kryetari i fesë). Krahas kësaj, kishte edhe dy *Ulema Mexhlis-a* (këshilla lokale), një në Sarajevë dhe tjetri në Shkup. Në çdo qytet kishte gjyqe sheriatit. Këto gjyqe vareshin nga Sarajeva dhe Shkupi dhe të gjitha së bashku nga Ministria e Drejtësisë në Beograd. Pas bashkimit të territoreve shqiptare, bashkimi dhe unifikimi i bashkësisë islame ishte një detyrë imperative.

KMSH bëri përpjekje që aktivitetin e tij fetar dhe edukativ ta shtrinte edhe tek shqiptarët e Çamërisë. Imami i Tepelenës, Jahja Hasani u porositi që të shkonte në Filat, Margëlliç, Paramithi, Gumenicë si dhe në qarqet që vareshin prej tyre për ligjërata. Në përfundim të këtij misioni, ai duhet të hartonte një raport të detajuar mbi gjendjen e myslimanëve shqiptarë të Çamërisë.³⁴

Një problem që doli pas bashkimit të Kosovës me Shqipërinë ishte çështja e gjykatave të Sheriatit. Në periudhën e paraluftës të gjitha çështjet civile ishin kompetencë e komuniteteve. Me ndryshimin e kufijve, ortodoksët dhe katolikët ruajtën prerogativat e tyre. Ndërsa myslimanët, megjithëse gëzonin të njëjtat të drejta si ortodoksët dhe katolikët, realisht nuk zbatonin të njëjtën praktikë. Kjo për shkak se gjykatat e Sheriatit, të cilat ishin degë të gjykatave të Paqit, e kishin pezulluar veprimtarinë e tyre për mungesë gjykatësish. Pjesa dërrmuese e tyre ishin boshnjakë dhe, me fillimin e luftës, u larguan nga Kosova. Emërimi i gjykatësve të rinj përbënte vështirësi: *së pari*, për mungesë kuadri dhe, *së dyti*, për faktin se do të ndikonte në statusin juridik të komuniteteve fetare. Komisari i Naltë Civil për Kosovën, Dibrën dhe Strugën, Fejzi Alizoti i sugjeroi Këshillit të Ministrave që deri në

³⁴ A. Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)...*, f. 329.

organizimin rrënjësor juridik të këtyre viseve kjo detyrë t'i ngarkohej përkohësisht myftinjve të emëruar nga KMSH-ja.³⁵

Ardhja e shumë nëpunësve civilë dhe fetarë nga viset e okupuara krijoi vështirësi të mëdha financiare për KMSH. Ai ishte i detyruar që, përveç rrogave, t'u siguronte atyre qiratë e banesave dhe dieta të ndryshme.³⁶ Bashkimi i Kosovës me Shqipërinë shtroi përpara KMSH edhe nevojën e emërimit të myftinjve të rinj, nëpunësve civilë dhe fetarë, të cilët përbënin gjithashtu një kosto plus në buxhetin e këtij institucioni.³⁷

Sipas buxhetit të aprovuar nga Këshilli i Përgjithshëm për vitin financiar 1941-1942, të ardhurat e KMSH-ës ishin 722.000 franga shqiptare, ndërsa harxhimet 751.129 fr., me një deficit vjetor i cili nuk përbënte ndonjë diferencë të madhe, prej 29.129 fr. në vit. Prandaj, kreu i KMSH, në përputhje me ligjin për komunitetet fetare, kërkoi shtimin e subvencionit.³⁸ Por, një kërkesë e tillë u refuzua nga qeveria, e cila mernte përsipër të subvenciononte vetëm 170.000 franga në vit.³⁹ Sipas saj, shtesat mund të planifikoheshin vetëm në një zë të jashtëzakonshëm dhe jo në buxhetin vjetor të përcaktuar sipas ligjit për komunitetet fetare.⁴⁰ Pjesë e këtij buxheti ishin edhe 10.000 fr. të destinuara për sektin alevian.⁴¹

Zhvillimet politike i imponuan disa personaliteteve të kohës nevojën për një riororganizim të institucioneve islame. Kryetari i bashkisë së Kukësit, Tahir Kolgjini kërkoi nga kryetari i imamëve të Prizrenit, Hafiz Abullah Telaku organizimin e një kongresi ku do të merrnin pjesë

³⁵ *AQSH*, F. 155, V. 1941, D. VIII-483, fl. 2. Letër e Komisarit të Naltë Civil për Kosovën, Dibërën dhe Strugën, Fejzi Alizoti, për Këshillin e Ministrave, Prizren, 15 nëntor 1941.

³⁶ *Po aty*, F. 155, V. 1941, D. VIII-487, fl. 2. Letër e kryetarit të KMSH-së, Dr. Bexhet Shapati, për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 18 shkurt 1941.

³⁷ *Po aty*, fl. 4. Letër e kryetarit të KMSH-së, Dr. Bexhet Shapati, për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 1 maj 1941.

³⁸ *Po aty*, fl. 6. Letër e kryetarit të KMSH-së, Dr. Bexhet Shapati, për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 3 qershor 1941.

³⁹ *Po aty*, fl. 8. Letër e Ministrisë së Drejtësisë, për kryetarin e KMSH-së, Dr. Bexhet Shapati, Tiranë, 30 qershor 1941.

⁴⁰ *Po aty*, fl. 12. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.1058, Tiranë, 20 gusht 1941.

⁴¹ *Po aty*, fl. 15. Letër e Ministrisë së Drejtësisë, për kryetarin e KMSH-së, Dr. Bexhet Shapati, Tiranë, 31 tetor 1941.

të gjithë imamët zyrtarë të territoreve të liruara.⁴² Në kongres morën pjesë disa delegatë të cilët hartuan këtë program: 1) Ky Kongres do të kishte si qëllim kryesor që t'i vinte në ndihmë bashkimit kombëtar; 2) Kongresi, si interpret i popullit mysliman të Kosovës, dëshironte që të kishte, sa të ishte e mundur, një organizim fetar për realizimin e parimeve të larta islame; 3) Derisa të stabilizohej gjendja juridike e vendeve të çliruara, Kongresi e mendonte të nevojshme që administrimi fetar të drejtohej prej një myftiu të Përgjithshëm dhe një Këshilli me katër anëtarë të zgjedhur nga ky Kongres, me qendër në Prizren. Ky Këshill do të kishte si kompetencë të zgjidhte sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Naltë të Sheriatit; 4) Myftiu i Përgjithshëm dhe Këshilli i Naltë i Sheriatit do të vareshin nga KMSH; 5) Këshilli i Naltë i Sheriatit do të kishte kompetencë të plotë për t'u kujdesur për organizimin fetar të këtyre vendeve, moralisht dhe materialisht, si: të propozonin, emëronin, pushonin, transferonin, të ndëshkonin me masa disiplinore, të kërkonin burime financiare, të kontrollonin dhe inspektonin pasuritë vakëfnore si dhe personelin fetar; të vendoste mbi shpenzime ose shpërblime të nevojshme. Të shqyrtonte mënyrën e bashkimit të institucioneve islame të territoreve të çliruara me KMSH, duke harmonizuar dispozitat e Statutit dhe të rregulloreve në fuqi në këto territore, për mbarëvajtjen e fesë islame; 6) Këshilli i Naltë i Sheriatit ngarkohej që të interesohej sa më shpejt për rregullimin institucional të lëndës së mësim-besimit në juridiksionin e vet; 7) Në harmoni me përmbajtjen e këtij programi, të gjitha kompetencat e Ulema Mexhllisit dhe ato të Drejtorisë së Vakëfeve të Shkupit, tani e tutje, t'i kalonin Këshillit të Naltë të Sheriatit në Prizren.⁴³

Delegatët e Kongresit Mysliman, konform programit të përcaktuar, në vend të Ulema Mexhllisit, vendosën krijimin e Këshillit të Naltë të Sheriatit, me qendër në Prizren. Në cilësinë e myftiut të Përgjithshëm, me

⁴² Tahir Kolgjini, "Mbledhja e klerit mysliman me 30 nanduer 1941 në Prizren", *Koha e Jonë*, Paris: prill-qershor 1986, f. 22-24.

⁴³ *AQSH*, F. 155, V. 1941, D. VIII-152, fl. 27. Procesverbal i Kongresit Mysliman në Prizren, Prizren, 1941. Delegatët në Kongresin Mysliman të Prizrenit ishin: Hafiz Abullah Hëziri, Asim Lusha, Hasan Islami, Hafiz Qemal, Hafiz Vejseli, Hasan Sulejmani, Imer Mustafa, Ahmet Latif, Mehmet Ademi, Sulejman Jakupi, Qemal Hamiti, Rexhep Bajrami, Rexhep Arifi, Fetah Haxhi Abdullah, Beqir Bajrami, Mehmet Haxhi Hasani, Bajram Shabani, Bahtjar Neziri, Salih Ramadani, Xhemal Limani, Faik Sherifi, Hafiz Sadik Shporta, Qemal Emimi, Qamil Hurshit, Beqir Hizir, Sulejman Esat, Abdyl Ahmeti, Ejup Bajrami, Maliq Sulejmani.

unanimitet votash, zgjodhën Hafiz Ali Krajën nga Shkodra, ndërsa si anëtarë, Haxhi Iljazi nga Prishtina, Hasan Islami nga Gjakova, Hafiz Sulejmani nga Tetova dhe Abullah Hëziri nga Prizreni.

Kongresi ngarkoi kryetarin e përkohshëm Hafiz Abdullah Hëzirin për t'i paraqitur respektin e delegatëve Mëkëmbësisë dhe Komisarariatit të Naltë Civil për Kosovë-Dibër-Strugë; për t'i dorëzuar autoriteteve administrative procesverbalet e diskutimeve, duke kërkuar lehtësirat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të marra në këtë Kongres.⁴⁴ Sipas Tahir Kolgjinit, ruajtja e njëfarë autonomie të institucioneve islame të Kosovës nga KMSH ishte një masë preventive për rrethanat që mund të krijoheshin pas humbjes së Fuqive të Boshtit. Por kjo nuk u pa me sy të mirë nga drejtuesit e institucioneve shtetërore dhe të KMSH. Prandaj, me kalimin e kohës institucionet islame të Kosovës u bashkuan me KMSH.

Probleme dhe sfida të KMSH

Rritja e popullsisë dhe përmirësimi i infrastrukturës urbane shtroi nevojën e ndërtimit të një xhamie të madhe. Kjo kërkesë, së bashku me planin për ndërtimin e dy xhamive në Kukës dhe Peshkopi, iu paraqit Mëkëmbësisë. Nga ana tjetër, Drejtoria e Vakëfeve u ngarkua për të kontraktuar një arkitekt për hartimin e projektit të xhamisë së madhe të kryeqytetit.⁴⁵ KMSH dikur kishte shfaqur dëshirën që ajo të ndërtohej para bashkisë së dikurshme, tek ish kinemaja verore “Skënderbej”, por ky truall ishte zënë me projektin “Banca di Napoli”. Prandaj urbanistët italianë shfaqën mendimin që xhamia e madhe të ndërtohej ose tek sheshi i Namazgjasë (aty ku ndodhet sot) ose tek posta e Pazarit të Ri, e cila do të shembej.⁴⁶

Regjimi fashist ndoqi një politikë, e cila synonte indoktrinimin e rinisë shqiptare me ideologjinë fashiste. Kështu, 10.000 fëmijë shqiptarë u dërguan për të kaluar pushimet verore në kolonitë shqiptare të Italisë. Kjo ishte një fushatë për t'i treguar atyre arritjet e regjimit fashist.⁴⁷ Një politikë e tillë vijoi për disa vite dhe u shfrytëzua nga instruktorët e seminareve katolike për t'i konvertuar fëmijët jetimë myslimanë në të

⁴⁴ *Po aty.*

⁴⁵ A. Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)...*, f. 332.

⁴⁶ *Po aty.*

⁴⁷ “Interesimi i regjimit fashist për fëmijët shqiptarë”, *Tomori*, nr.52, Tiranë, 2 maj 1940, f. 2.

krishterë. Disa prej tyre ishin detyruar të shkonin në kisha e të bënin kryq. Kjo gjë e indinjoi jashtëzakonisht KMSH dhe e ngarkoi Këshillin e Përgjithshëm me një barrë të rëndë morale. Sipas Ferit Vokopolës, kjo ishte edhe përgjegjësi e qeverisë. Kryesia e KMSH-ës bëri demarshe për të ndaluar fëmijët myslimanë të Strehës Vorfnore që të shkonin në kisha dhe kërkoi që ata të ktheheshin urgjentisht në Shqipëri. Kishte informacione se në Itali po bëheshin përpjekje për të konvertuar edhe ushtarët shqiptarë që ishin rekrutuar nga ushtria italiane. Për zgjidhjen e këtij problemi u vendos që në Ministrinë e Drejtësisë të dërgohej një komision i posaçëm.⁴⁸

Në funksion të situatës politike, Këshilli i Ministrave kërkoi nga KMSH të mobilizonte shtypin islam dhe klerikët për të shkruar artikuj dhe bërë predikime fetare kundër vëllavrasjes që kishte pllakosur vendin. Kryesia e KMSH urdhëroi revistën *Kultura Islame* të botonte materiale, ndërsa vaizët të shkruanin artikuj e të bënin predikime, duke shpjeguar se parimet e fesë islame ishin kundër vëllavrasjes.⁴⁹

Një aspekt tjetër i veprimtarisë fetaro-edukative në këtë periudhë ishte emërimi i disa klerikëve me detyrën e vaizit shëtitës në zonat rurale. Kjo ishte një nevojë e madhe për shkak se hoxhallarët në këto zona nuk gëzonin të njëjtin nivel dhe përgatitje teologjike si ata të qendrave urbane.⁵⁰

Sektet dhe tarikatet e ndryshme të Tokave të Liruara u bashkuan me organizatën “Drita Hyjnore”. Tarikati halveti, i cili në vitet 20-30 nuk kishte mundur të shkëputej dhe të krijonte një entitet më vete, njoftoi kryesinë e KMSH se dëshironte të lidhej me këtë organizatë. Në fakt, si halvetitë ashtu dhe “Drita Hyjnore” ishin pjesë e KMSH, por të mbetur jashtë një përkujdesjeje të veçantë siç ndodhte me tarikatet e tjera, ata po humbisnin çdo ditë e më shumë. Kjo bëri që drejtuesit e halvetive, në bazë të rregullores, t’i kërkonin KMSH-ës bashkimin, në aspektin juridik dhe administrativ, me këtë organizatë.⁵¹

⁴⁸ AQSH, F. 482, V. 1942, D. 3, fl. 16-17. Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm të KMSH-së, Tiranë, 29 maj 1942.

⁴⁹ A. Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)*..., f. 313.

⁵⁰ *Po aty*, f. 316-317.

⁵¹ AQSH, F. 155, V. 1942, D. VIII-541, fl. 2. Letër e drejtuesit të tarikatit halveti, për kryesinë e KMSH-së, Tiranë, 21 nëntor 1942.

Përpyjekjet e disa krerëve kosovarë për krijimin e një institucioni të pavarur nga KMSH

Në fund të prillit 1942 në Kosovë filloi një përpjekje e cila synonte organizimin e një *Ulema Mexhlisi* të veçantë nga ai që kishte ekzistuar në vitet e paraluftës. Iniciatorët e kësaj lëvizjeje ishin personalitete me influencë politike si, Ferhat Draga dhe Iljaz Agushi apo hoxhallarë si Asim Lusha, hoxha i Istogut etj. E veçanta e kësaj lëvizjeje qëndronte se përfaqësuesit e saj nuk synonin bashkimin me KMSH. Ata e justifikonin këtë qëndrim me argumente të karakterit dogmatik, që kishin të bënin me ruajtjen e principeve të fesë islame. Sipas tyre, “myslimanët e Shqipërisë së Vjetër nuk ishin myslimanë të mirë dhe kishin dalë jashtë rregullave fetare; se bektashizmi ishte përhapur së tepërmi; se në Kosovë aplikoheshin Sheriati, ndërsa në pjesën tjetër jo”. Në gjykimin e tyre, ata duhej të organizoheshin më vete, për të ndaluar mikrobin e liberalizmit dhe të bektashizmit që të hynte në Kosovë.

Inspektoriati Epror për Kosovën kishte bindjen se ata i besonin me të vërtetë këto argumente, por, sipas tij, kishte dhe disa arsye që ata nuk i artikulonin hapur. Kështu, vakëfet e Kosovës ishin mjaft të pasura krahasuar me ato të Shqipërisë, të ardhurat e të cilave ata dëshironin t'i administronin vetë. Ata gjithashtu donin që me anë të *Ulema Mexhlisi*-t të ushtronin në popull një influencë politike më të madhe. Kjo e fundit ishte një arsye e rëndësishme, e cila tregon se, personalitetet politike kosovare kërkonin t'i shpëtonin kontrollit të centralizuar të institucioneve islame nga KMSH-ja, i cili në këtë periudhë ishte nën survejimin dhe imponimin e vijës politike të regjimit fashist. Ata kërkonin që këto institucione t'i përdornin në funksion të interesave politike dhe kombëtare që do të shtronte koha. Ferhat Draga dhe Iljaz Agushi kishin një përvojë të hidhur nga periudha e ish Jugosllavisë, se si kjo e fundit kishte përdorur disa klerikë të kompromentuar për të nxitur emigrimin e kosovarëve drejt Turqisë. Në këndvështrimin e tyre, institucionet e bashkësisë islame dhe kleri ishin një instrument i rëndësishëm për mbrojtjen e interesave kombëtare. Prandaj, ato duheshin mbajtur jashtë influencave të huaja politike.

Por pjesa dërrmuese e krerëve dhe e klerikëve kosovarë e kundërshtuan këtë alternativë dhe kërkuan bashkimin e tyre me KMSH. Një pikëpamjeje të tillë i përmbahej edhe Inspektoriati Epror për Kosovën të cilin e drejtonte Koço Tasi. Ai shprehte mendimin se

autonomia e bashkësisë islame në Kosovë do të kishte pasoja të dëmshme për këto arsye: ajo do të formonte një argument politik për serbët, të cilët, padyshim, do ta përdornin kur të shfaqej rasti për të provuar se myslimanët e Kosovës, nuk ishin një me myslimanët e Shqipërisë; po të krijohesh një institucion i pavarur, do të ishte vështirë të suprimohej me mbarimin e luftës dhe do të duhej të derdhej shumë djersë, mbase dhe gjak, për të ndrequr gabimet e bëra; do të pengonte evoluimin shoqëror; do t'u jepte një armë të fortë injorantëve-konservatorë e reaksionarë, të cilët, me anën e saj, mund të influenconin në të ardhmen të gjithë jetën politike dhe shoqërore të kombit. Për këto arsye, Inspektoriati Epror për Kosovën ishte i mendimit që qeveria ta zgjidhte sa më shpejt këtë problem. Ai ishte për shtimin e subvencioneve jo vetëm ndaj klerit mysliman, por edhe ndaj atij ortodoks e katolik.⁵²

Krijimi i Këshillit të Ulemave

Në funksion të politikës religjioze që regjimi fashist ndoqi në këtë periudhë ishte edhe riorganizimi i bashkësisë islame. Ministria e Drejtësisë e arsyetonte ristrukturimin e KMSH me bashkimin e myslimanëve shqiptarë të Tokave të Liruar me ato të Shqipërisë. Por meqë kjo çështje kishte një karakter urgjent dhe elaborimi i një Statuti të ri kërkonte kohë, u pa e nevojshme që, fillimisht, të krijohesh një këshill administrativ me emrin Këshilli i Ulemave, për të ushtruar funksionet e kryetarit të KMSH-së dhe të Këshillit të Përgjithshëm, të cilët, me hyrjen në fuqi të dekretligjit të propozuar, konsideroheshin të shkarkuar.⁵³ Këshilli i Ministrave e justifikonte këtë ndryshim edhe me “rendin botëror” që ishte krijuar.⁵⁴

Më 9 qershor 1942, Mëkëmbësi i Përgjithshëm dekretoi krijimin e Këshillit të Ulemave, i cili do të zëvendësonte Këshillin e Përhershëm dhe të Përgjithshëm të KMSH-së, duke i hapur rrugën *de jure* ristrukturimit dhe unifikimit të bashkësisë islame me institucionet e Tokave të Liruar. Pjesëtarët e Këshillit të Ulemave e merrnin funksionin

⁵² *Po aty*, F. 149, V. 1942, D. VI-155, fl. 2-3. Letër e Koço Tasit për Kryeministrinë, Prizren, 28 prill 1942.

⁵³ *Po aty*, F. 155, V. 1942, D. VIII-501, fl. 5. Dekretligj për krijimin e Këshillit të Ulemave, Tiranë, 9 qershor 1942.

⁵⁴ *Po aty*, fl. 1. Letër e Kryeministrit, Mustafa Kruja, për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 2 prill 1942.

pas betimit përpara Mëkëmbësit të Përgjithshëm. Ndërsa ish kryetarit të KMSH, Dr.Bexhet Shapatit i lidhej një rrogë jetike prej 600 fr. shqiptare.⁵⁵

Në krye të Këshillit të Ulemave, qeveria dhe Mëkëmbësi u përpoqën të emëronin personalitete nga trojet etnike ose që gëzonin kredibilitet në popull për kontributin e tyre patriotik. Kryetar i Këshillit të Ulemave u zgjodh H.Sherif Langu nga Dibra, nënkryetar u zgjodh H.Ali Korça,⁵⁶ por ky i fundit deklaroi dorëheqjen dhe nuk u paraqit fare në detyrë.⁵⁷ Kjo tregonte se nuk mungonin përfaqësues të klerit mysliman me integritet të lartë moral dhe politik, të cilët e kishin kuptuar se KMSH e kishte humbur sovranitetin e dikurshëm së bashku me shtetin e pavarur shqiptar, dhe nuk pranuan të përdoreshin nga regjimi fashist.

Në vend të H.Ali Korçës u emërua Dervish Hilmi Islami nga Libohova.⁵⁸ Një qëndrim të ngjashëm mbajti edhe Ferit Vokopola. Ai dha dorëheqjen si Drejtor i Përgjithshëm i Vakëfeve, me justifikimin se, e konsideronte si obligim meqë Këshilli i Përgjithshëm që i kishte besuar këtë funksion ishte suprimuar.⁵⁹ Kjo detyrë iu besua përkohësisht pa shpërblim kryetarit, H.Sherif Langut, i cili më vonë i propozoi qeverisë që në këtë post të emërohej, Salih Vuçiterni.

Në qershor të vitit 1942, Ministria e Drejtësisë kërkoi nga Këshilli i Ulemave të fillonte punën për hartimin e Statutit të ri, i cili do të miratohej nga qeveria dhe më pas do t'i dërgohej Mëkëmbësit për dekretim. Për këtë detyrë u ngarkuan dy personalitete të njohur të kohës, Haki Sharofi dhe Jonuz Bulej. Qeveria urdhëroi Këshillin e Ulemave që të anulonte të gjitha vendimet e ish-Këshillit të Përhershëm të KMSH, që ishin marrë në lidhje me problemet e konstatuara në Tokat e Liruara. Me këtë vendim u abroguan të gjitha emërimet si myfti, nënmyfti etj., në këto territore, duke i hapur rrugën spastrimit të elementëve që konsideroheshin nacionalistë dhe kundërshtarë të regjimit fashist. Këtu bënin përjashtim

⁵⁵ “Reforma e Statutit të Komunitetit Mysliman Shqiptar”, *Tomori*, nr.138, Tiranë, 10 qershor 1942, f. 1.

⁵⁶ *AQSH*, F. 155, V. 1942, D. VIII-502, fl. 43. Dekret i Mëkëmbësit të Përgjithshëm, Tiranë, 2 nëntor 1942.

⁵⁷ *Po aty*.

⁵⁸ *Po aty*, fl. 42. Letër e Kryeministrit dhe zëvendësministrit të Drejtësisë, Mustafa Kruja, për Këshillin e Ministrave, Tiranë, 1942.

⁵⁹ *Po aty*, F. 482, V. 1942, D. 12, fl. 41. Letër e Ferit Vokopolës drejtuar Kryesisë së KMSH-së, Tiranë, 10 qershor 1942.

vetëm nëpunësit e zyrave vakëfnore, që ishin në këto detyra, që nga koha e ish Jugosllavisë. Derisa të aprovohej Statuti dhe rregulloret e reja, u vendos që të mbeteshin në fuqi statuti e rregullat e periudhës së ish Jugosllavisë.

Bashkimi i institucioneve islame të Kosovës me Shqipërinë shtroi nevojën e rritjes së personelit dhe kërkesën për zyra. Ndërtesa ku ishte vendosur fillimisht Mëkëmbësia ishte vakëf. Megjithëse ky institucion u transferua në lagjen Tirana e Re,⁶⁰ qeveria refuzoi që t'ia kthente KMSH-së ndërtesën, duke u justifikuar se nevojitej për zyra të tjera.⁶¹

Trysnia mbi këtë institucion sa vinte dhe rritej. Kjo politikë vijoi të intensifikohej me acarimin e situatës politike. Ministria e Brendshme udhëzoi prefekturat se një nga klasat shoqërore ku regjimi mund të mbështetej për ndihmë kundër përhapjes së komunizmit, ishte kleri i tre besimeve. Ajo kërkoi nga drejtuesit lokalë që kleri të mos shtyhej në indiferentizëm e në pozicion kundërshtues ndaj qeverisë, por të bëhej kujdes dhe të mos prekej dinjiteti i komuniteteve si ent e kolektivitet moral dhe fetar.⁶²

*Struktura religjioze e popullsisë shqiptare brenda kufijve londinezë
(31 dhjetor 1942)⁶³*

Besimi	Meshkuj	Femra	Shuma	% banorë	Banorë për km ²
Myslimanë	405.993	370.867	776.860	69.0	27
Ortodoksë	119.565	112.307	231.872	20.7	8
Katolikë	59.070	56.894	115.964	10.3	4
Besime të tjera	77	70	147
Shuma	584.705	540.138	1.124.843	100.0	39

Vendosjes së lëndës së mësim-besimit në shkolla, KMSH i dha rëndësi të madhe, për shkak se kjo çështje përbënte një interes themelor për përhapjen dhe konsolidimin e fesë islame. KMSH kërkoi që kjo lëndë të zhvillohej edhe në shkollat rurale, por buxheti i limituar nuk e lejoi

⁶⁰ *Po aty*, F. 155, V. 1942, D. VIII-507, fl. 28. Letër e kryetarit të Këshillit të Ulemave, H.Sherif Langu, për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 14 shtator 1942.

⁶¹ A. Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)*..., f. 342.

⁶² *AQSH*, F. 379, V. 1943, D. 696, fl. 1. Qarkore e Ministrisë së Punëve të Brendshme për prefekturat, Tiranë, 19 qershor 1943.

⁶³ *Po aty*, F. 188, V. 1942, D. 98, fl. 175. Struktura religjioze e popullsisë shqiptare, Tiranë, 31 dhjetor 1942.

diçka të tillë. Gjithashtu kërkoi nga Ministria e Arsimit që mësim-besimi të vendosej si lëndë e detyrueshme.⁶⁴ Kjo e fundit u tregua e gatshme dhe bëri përpjekje që ta fuste dhe në shkollat e mesme, por kërkoi që komunitetet fetare të informonin se sa mësues kishin në dispozicion për zhvillimin e kësaj lënde.⁶⁵

Bashkimi i trojeve shqiptare solli një sërë vështirësish për shkak të mungesës së personelit civil dhe fetar. Për plotësimin e këtyre nevojave, Sheh Abedini nga Tetova i parashtroi Mëkëmbësisë disa kërkesa, si: krijimin e një medreseje të përgjithshme për të nxjerrë gjyqtarë; ndihmë financiare për të plotësuar mungesat e medreseve; të përjashtoheshin nga shërbimi ushtarak nxënësit e tyre derisa të mbaronin studimet dhe gjatë shërbimit t'u jepeshin detyra të përshtatshme; në shkollat publike, krahas mësimëve e provimeve të tjera, të zhvilloheshin edhe ato fetare; të themelohej një shkollë normale fetare në Kosovë; në Prishtinë të krijohet një medrese si ajo e Tiranës.⁶⁶ Këto kërkesa ishin pasqyrim i nevojave që klerikët dhe besimtarët myslimanë të Kosovës dhe Shqipërisë Juglindore kishin për kadro të kualifikuar, që krahas detyrave fetare në xhami dhe teqe, të merreshin dhe me zgjidhjen e problemeve juridiko-civile, siç ishte martesë, divorci, probleme të trashëgimisë etj.

KMSH në periudhën e pushtimit gjerman (1943-1944)

Në prag të kapitullimit të Italisë, për shkak të luftimeve, një numër i madh xhamish pësuan dëmtime serioze. KMSH i kërkoi Ministrisë së Drejtësisë kompensimin e dëmeve që kishte pësuar xhamia e Kukësit, Burrelit, Burgajetit, Pukës, Pezës etj.⁶⁷ Një problem tjetër mbetej përvetësimi i vakëfeve të KMSH nga persona të pandërgjegjshëm, që duke shfrytëzuar rrethanat e luftës, grabitën një sasi të konsiderueshme pronash.

⁶⁴ *Po aty*, F. 155, V. 1942, D. VIII-503, fl. 1-2. Letër e kryesisë së KMSH-së për Ministrinë e Arsimit, Tiranë, 21 shtator 1942.

⁶⁵ *Po aty*, fl. 7. Letër e Ministrisë së Arsimit për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 22 tetor 1942.

⁶⁶ *Po aty*, F. 155, V. 1943, D. VIII-544, fl. 1. Letër e Sheh Abidinit nga Tetova, për Mëkëmbësinë e Përgjithshme, Tiranë, 27 prill 1943.

⁶⁷ *Po aty*, F. 482, V. 1943, D. 4, fl. 7. Letër e kryesisë së KMSH-së për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 1943.

Me kapitullimin e regjimit fashist doli në skenë restaurimi i KMSH. Më 8 janar 1944, paria e Dibrës i dërgoi Kryetarit të Këshillit të Naltë të Regjencës, Mehdi Frashërit një peticion, në të cilin, gjendjen e KMSH nën Italinë fashiste e konsideronte si një plagë shpirtërore. Sipas tyre, nuk kishte asnjë njeri, që i pikëlluar, të mos pyeste veten “A kemi Komunitet Mysliman në Shqipëri”? Në mes ilegaliteteve të pafalshme të qeverisë së Mustafa Krujës, ata nënvizonin ndërhyrjen arbitrare në administratën e KMSH dhe shkeljen e Statutit të këtij institucioni. Ata i bënë thirrje autoriteteve qeveritare që të kujdeseshin sa më parë për shërimin e kësaj plage shpirtërore.”⁶⁸ Të gjitha veprimet e ndërmarra ata i konsideronin të paligjshme dhe në shkelje të Statutit e të Kodit Civil. Në përputhje me legjislacionin e shtetit shqiptar, ata kërkonin që të anulohet dekretligji ilegal Jakomoni-Kruja, i cili me metoda fashiste kishte suprimuar Këshillin e Përgjithshëm të KMSH; të thirreshin anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm, duke përfshirë nga një anëtar nga prefekturat e Tokave të Liruara dhe të vendosnin mbi bashkimin e të gjithë myslimanëve në të njëjtin komunitet. Ky Këshill i Përgjithshëm të formonte një komision për ndryshimet që mund t'i bëheshin Statutit; të kontrollonte veprimet ilegale që mund të ishin bërë dhe të vendoste mbi aprovimin dhe disapprovimin e këtyre veprimeve sipas rastit; të zgjidhte kryetarin e komunitetit, kryemyftinjët e dy ose tre zonave që duhej të krijoheshin në periferi të territoreve të çliruara ashtu dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Vakëfeve. Krerët e Dibrës kërkonin të merreshin masa të menjëhershme, duke i konsideruar të drejtat kombëtare dhe ato fetare si të pacenueshme nga askush.⁶⁹

Edhe një grup besimtarësh nga Shkodra, i dërguan Kryetarit të Këshillit të Naltë të Regjencës, Mehdi Frashërit një letër ku theksohej se gjatë okupacionit fashist, KMSH i ishte mohuar e drejta dhe liria e ushtrimit fetar, duke mos lejuar që të zgjidhte drejtuesit e vet dhe se kishte mbetur pa Statut, sepse Këshilli i Ulemave nuk e kishte hartuar statutin e ri, që ishte ngarkuar të hartonte sa më parë. Prandaj, edhe ata kërkonin abrogimin e dekretligjit të Mëkëmbësit fashist dhe rivendosjen e Statutit të vitit 1929.⁷⁰

⁶⁸ *Po aty*, F. 155, V. 1944, D. VIII-564, fl. 4-5. Peticion i parisë së Dibrës, Tiranë, 8 janar 1944.

⁶⁹ *Po aty*, fl. 6.

⁷⁰ *Po aty*, fl. 3. Letër e një grupi myslimanësh shkodranë për Kryetarin e Këshillit të Naltë, Mehdi Frashëri, Shkodër, 15 dhjetor 1943; *po aty*, fl. 11. Letër e një grupi

Këto kërkesa tregonin qartë se pjesa dërrmuese e përfaqësuesve të klerit mysliman shqiptar dhe besimtarëve të thjeshtë ishin kundër ndërhyrjeve të qeverisë kuislinge të Mustafa Krugës, Mëkëmbësit Françesko Jakomoni dhe regjimit fashist në punët e brendshme të KMSH. Por, ata nuk shfaqnin asnjë kundërshtim për sa i përket bashkimit institucional të myslimanëve shqiptarë të Tokave të Liruar me KMSH. Përkundrazi, në të gjithë dokumentacionin e shqyrtuar konstatohet qartë prirja unifikuese e myslimanëve shqiptarë të të gjitha trojeve në një qendër drejtuese dhe kooptimi i përfaqësuesve të myftinive të Kosovës në Këshillin e Përgjithshëm të KMSH.

Një problem që u shfaq në këtë periudhë ishte shtetëzimi i trojeve për nevojat e planeve rregulluese të qyteteve. Në Tiranë dhe në Durrës shtetëzimi i tyre ishte bërë pa asnjë dëmshpërblim, duke dëmtuar të ardhurat financiare të KMSH-së. Përpjekjet për të prishur Medresenë e Vjetër si dhe varrezat e rrugës së Durrësit, me ndërhyrjen e KMSH-së, u anuluan. Gjithsesi, nuk ishin të rralla rastet kur një sërë objektesh e pronash të këtij institucioni u prishën për nevojat e urbanizimit të kryeqytetit, hapjes së rrugëve të reja dhe ndërtimit të godinave në dobi të interesit publik.⁷¹

*Organizimi administrativ i institucioneve islame
në Tokat e Liruar në vitin 1944*

Nr	Kryemyftinia	Qytetet
1	Prizren	Gjakovë, Suharekë, Rahovec, Dragash
2	Prishtinë	Gjilan, Ferizaj, Drenicë
3	Pejë (për arsye se nuk ishte parashikuar në buxhet për kryemyftini, mbetej myftini, por do të komunikonte drejtpërsëdrejti me Këshillin e Ulemave)	Istog, Plavë, Guci, Rozhajë, Tutinë
4	Dibër e Madhe	Gostivar, Tetovë, Kërçovë, Rekë, Strugë

Rrethanat e luftës dhe vështirësitë e mëdha financiare me të cilat u përball administrata shtetërore pas kapitullimit të Italisë, u shoqëruan me ndërprerjen e subvencionit vjetor për komunitetet fetare. Kjo ndikoi drejtpërsëdrejti në rrogat e personelit. Drejtori i Përgjithshëm i Vakëfeve

myslimanësh shkodranë për Kryetarin e Këshillit të Naltë, Mehdi Frashëri, Shkodër, 25 shkurt 1944.

⁷¹ A. Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)*..., f. 333.

në KMSH, Salih Vuçiterni i shkruante Ministrisë së Drejtësisë, se jo vetëm që nuk kishte filluar ende kalimi i subvencionit të vitit 1944, por nga viti 1943 kishin mbetur pa u likuiduar për llogari të këtij institucioni edhe 835.717.15 franga shqiptare.⁷²

Në vitet e Luftës së Dytë Botërore, KMSH u dëmtua më shumë nga të gjitha komunitetet e tjera fetare. Kjo për shkak të peshës numerike që ata zinin në raport me shqiptarët e besimeve të tjera dhe se institucioni i tyre ishte zotërues i një sasive të konsiderueshme pronash, objektesh civile dhe xhamish, të cilat u konfiskuan, dëmtuan e shkatërruan.

S u m m a r y

ALBANIAN MUSLIM COMMUNITY DURING THE SECOND WORLD WAR (1939-1944)

The Italian occupation created new circumstances for the Muslim Community and Albanian Muslims. The leaders of KMSH (Albanian Muslim Community) faced a very difficult situation. In some circles it was openly discussed that Muslims must flee to Asia. This pushed the chairman of the KMSH and clerics to back the invaders.

The conformism of the president, Dr. Bexhet Shapati aroused the discontent of the Muslims. A petition addressed to the Prime Minister, signed by 40 pious, asked the reformation of the KMSH. As a result, according to them, it was necessary to form an assembly, which would review the ongoing activity of this institution, determine the necessary measures and construct the General Council.

To indulge the clergy, the fascist invaders used several tactics. Firstly, they revised the secular and modern reforms that had been implemented during the republic and monarchy in the field of education, where the subject of religion had been extremely reduced. As part of their policy, Italians reformed

⁷² AQSH, F. 155, V. 1944, D. VIII-570, fl. 39. Letër e Drejtorit të Përgjithshëm të Vakëfeve në KMSH, Salih Vuçiterni, për Ministrinë e Drejtësisë, Tiranë, 9 tetorit 1944.

the KMSH, by removing from office all clerics who were considered nationalists and anti-fascists.

The unification of Kosovo with the Albanian state created new circumstances for the KMSH. This resulted in the unification of Islamic religious institutions. The congress held in Prizren, formulated essential issues regarding the path to be followed for the unification of the Islamic community.

During the German occupation, the KMSH faced unexpected situations. Unlike the Italians, the Germans did not have the time needed to intervene directly in the problems of the administration and the management of the KMSH. These and related issues faced by Albanian Muslims and the KMSH during World War II consist the focus of this article.